

## Publikohet revista elektronike "Komiteti Shtetëror për Diasporën"




Revista elektronike "Komiteti Shtetëror për Diasporën" është një pasqyrë e plotë e të gjitha vendimeve të miratura dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për Diasporën. Komiteti luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e pozitës së shqiptarëve jashtë vendit. Funksion i tij është përgatitja e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e Diasporës, mbështetja dhe monitorimi i veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën si dhe koordinimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Diasporën. Ky komitet drejtohet nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe në përbërje të tij janë anëtarët e kabinetit që drejtojnë ministrinë të fushave të mundshme për bashkëpunim me Diasporën. Ndër vite, kontributi i Diasporës shqiptare ka pasur rëndësi në aspektin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit, prandaj institucionet shtetërore po vijnë punën e tyre në zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse të shtetit shqiptar me qëllim nxitjen, angazhimin dhe bashkëpunimin e Diasporës në fusha të ndryshme.

## Mbledhja e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën



Në mbledhjen e radhës me Grupin e Koordinatorëve për zbatimin e "Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024", ku u bë një përmbledhje e punës së realizuar nga Grupi i Koordinatorëve deri më tani, u diskutua për ecurinë e mëtijshme për ndjekjen dhe zbatimin e masave të Planit të veprimit si dhe u prezantuan aktivitetet në vijim.

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



## QBD, përmbyll dërgesat e teksteve falas në Diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Postën Shqiptare përmbylli dërgesën me tekstet shkollore për mesimdhënien në Diasporë drejt Anglisë, Kroacisë, Turqisë, Greqisë, Italisë, Polonisë, Ukrainës, Belgjikës, Rumanisë, Çekisë, Sllovenisë dhe SHBA-së. Tekstet kanë mbërritur në destinacione dhe po shpërndahen në ambasadat e konsullatat përkatëse.

## Takimi me artistët e koncertit "Diaspora Shkencore"

Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko priti në një takim pianistin shqiptar që jeton në SHBA, Redi Llupa dhe violonçelistin argjentinas, Juan Sebastian Delgado. Gjatë bashkëbisedimit me ta, ministri Majko përgëzoi dyshen artistike për punën që po bëjnë në promovimin e muzikës dhe kompozitorëve shqiptarë kudo në botë. Gjithashtu edhe studiuesin Vaso Tole për punën e bërë në organizimin e këtij koncerti. Dyshja artistike interpretoi në koncertin "Diaspora Artistike dhe Shkencore-SHBA", i cili u organizua nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Diasporën.



## Drejtoresha e QBD-së takohet me Kryetaren e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi



Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa zhvilloi një takim me Kryetaren e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi znj. Anila Velaj Kila, për të diskutuar rreth problematikave dhe nevojave të mësuesve dhe nxënësve në Diasporë. Ndër të tjera u diskutua për hapat e ndërmarrë për hartimin e teksteve të reja dhe për literaturën shtesë në ndihmesë të mesimdhënies. U diskutua gjithashtu dhe për bashkëpunimin për organizimin e Takimit Mbarëkombëtar të Mësuesve të Diasporës që do të mbahet në mars të vitit të ardhshëm.



## AKD në Ukrainë

Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Diasporës po zhvillojnë një vizitë pune në Ukrainë ku janë takuar me zëvendësguvernatorin e rajonit të Zhaparozhy në Ukrainë, z. Gygnii Eduard Anatolievich. Gjatë kësaj vizite u shoqëruan nga Konsulli i nderit të Shqipërisë në Ukrainë, Shahin Omanov. Në këtë takim, z. Anatolievich u njoh më tepër me politikat shtetërore të hartuara për Diasporën dhe misionin e AKD-së për promovimin e kulturës shqiptare.

## Përfaqësues të AKD takojnë komunitetin shqiptar në Devnja



Në Ukrainë, dy përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës janë takuar me banorët e fshatit Devnja. Rreth 60% e popullsisë së këtij fshati janë me origjinë shqiptare. Gjatë bashkëbisedimit me ta, përfaqësuesit nga AKD iu treguan atyre më tepër për misionin e institucionit, projektet e realizuara dhe punën që po bëhet për mbështetjen e komuniteteve shqiptare kudo në botë. Gjithashtu u bë e ditur se edhe në këtë rajon do të vazhdohet me programin për shqiptarët e Ukrainës që t'u ofrohen atyre kurse për mësimin e gjuhës shqipe dhe folklorit shqiptar, të cilat do të realizohen në kuadër të marrëveshjes me AKD-së dhe TKOB-së.

## Njihen patentat shqiptare në Itali

Prej datës 8 shtator 2019, patentat shqiptare të lëshuara nga data 24 janar 2017 e deri më sot, do të njihen edhe në shtetin italian. Lajmi është bërë publik në faqen zyrtare të Ministrisë Italiane të Infrastrukturës dhe Transportit, ku është publikuar edhe lista e dokumentacionit që kërkohet për njohjen e lejeve të drejtimit. Njohja dhe konvertimi i patentave shqiptare në Itali është rezultat i një pune të organizuar dhe të drejtuar nga Koordinatori Shtetëror i Patentave, zëvendësmiester i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli me institucionet italiane.

